

Zyra e Shtypit  
16 janar 2009

## Mbi ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun valutor gjatë tremujorit të tretë vitit 2008

### 1. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË

**Tabelë 1:** Vëllimi i operacioneve të tregut të hapur (në milionë lekë).

DATA	Injektivim likuiditeti	
	R/REPO njëjavore	R/REPO njëditore
03.07.2008	5,720.00	
10.07.2008	3,000.00	
17.07.2008	5,000.00	
24.07.2008	6,000.00	
31.07.2008	4,400.00	
07.08.2008	6,000.00	
14.08.2008	7,200.00	
21.08.2008	4,200.00	
28.08.2008	4,200.00	
04.09.2008	4,300.00	
11.09.2008	2,400.00	
18.09.2008	1,000.00	
23.09.2008		2,000.00
24.09.2008		3,000.00
25.09.2008	4,600.00	

#### 1.1. Operacionet e tregut të hapur

Ndërhyrjet në tregun e parasë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2008, kanë vijuar të kryhen nëpërmjet instrumentit kryesor të Bankës së Shqipërisë, *marrëveshjes së anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor*, me një mesatare javore prej 4.46 miliardë lekësh.

Banka e Shqipërisë ndërhyri në dy raste edhe me instrumentin rregullues të saj, *marrëveshje të anasjelltë riblerjeje me maturim njëditor*, përkatësisht në shumat 2.00 dhe 3.00 miliardë lekë.


#### 1.2. Përdorimi i instrumenteve mbështetëse

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2008, për investimin e likuiditeteve të lira, bankat përdorën depozitën njëditore, niveli mesatar ditor i të cilës ishte 5.07 miliardë lekë, në krahasim me 3.8

miliardë lekë në tremujorin e kaluar. Rritja e likuiditetit të investuar në depozitë njëditore ishte rezultat i rritjes së nivelit strukturor të likuiditetit të mbajtur nga bankat e nivelit të dytë. Ndërsa, instrumenti i kredisë njëditore gjeti përdorim rreth 0.95 miliardë lekë në 4 raste.

Grafiku i mëposhtëm paraqet në mënyrë të përmbledhur ndërrhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë, gjatë nëntëmuajorit të parë të vitit 2008.

**Grafik 1:** Ndërrhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë gjatë nëntëmuajorit të parë të vitit 2008.



## 2. NDËRRHYRJET NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR

### 2.1. Veprime me bankat e nivelit të dytë

Gjysma e parë e tremujorit të tretë të vitit 2008 ka qenë pozitiv për tregtimin e monedhës vendase. Leku ka fituar terren ndaj monedhave të huaja, si pasojë e disbalancës midis ofertës së lartë sezonale dhe kërkesës më të ulët. Kjo disbalancë i ka krijuar mundësi Bankës së Shqipërisë të blejë valutë, në plotësim të objektivit të Rezervës Ndërkombëtare Neto. Si rezultat i ndërhyrjeve të Bankës së Shqipërisë, gjatë tremujorit të tretë të vitit 2008, është blerë valutë në masën e 10.9 miliardë lekë.

### 2.2. Veprime me institucione të tjera

Gjatë kësaj periudhe, kanë vijuar të realizohen veprime të shitjes dhe të blerjes së valutës me Ministrinë e Financave. Shitjet e valutës gjatë tremujorit të tretë llogariten në 1,232.76 milionë lekë, ndërsa blerjet qenë 33.02 milionë lekë.

Blerjet e valutës nga institucionet e huaja llogariten në 84.98 milionë lekë (Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim, IDA dhe Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, IBRD).

<b>Institucioni financiar</b>	<b>Blerje të valutës (në milionë lekë)</b>	<b>Shitje të valutës (në milionë lekë)</b>
MINISTRIA E FINANCAVE	33.02	1,232.76
TË TJERA (IDA, IBRD)	84.98	

---